

**REKOMANDIME BAZUAR NË GJETJET E**  
**KONFERENCËS “KONSOLIDIMI I REFORMËS ADMINISTRATIVE DHE**  
**TERRITORIALE: PRAKTIKA DHE MËSIMË”**  
**DHE**  
**PILOTIMIN E MODELIT TË “ZYRAVE TË INTEGRUARA ME NJË NDALESË”**

Tiranë 8 Qershor, 2015

1. Hartimin e një **Udhëzimi për Rregullimin e procesit të punës për ofrimin e shërbimeve ndaj publikut nga NJQV dhe Njësitë Administrative**<sup>1</sup>. **Lidhja 1** referon elemente të përmbatjes.
2. **Kriteri i funksionalitetit** të përfshihet si kriter analitik, cilido qoftë instrumenti planifikues që NJQV do të zgjedhin të shfrytëzojnë në të ardhmen, për ta garantuar në këtë mënyrë koherencën metodologjike mes dizenjimit të territorit dhe zhvillimit të mëtejshëm të tij<sup>2</sup>. Ky sugjerim vlen sidomos për fazën tranzitore të NJQV të rikonstituara.
3. **Modeli standart i planifikimit strategjik** të NJQV ngelet (siç e parashikon dhe drafti i *Strategjisë së Decentralizimit*) e ashtuquajtura metodologji SDP(e)MTBP<sup>3</sup> (planifikim strategjik I harmonizuar me buxhetin afatmesëm), ku (e) përfaqëson *instrumentin e planifikimit financiar afatmesëm*.
4. Jetësimi i reformës territoriale administrative duhet mbështetur me projekte konkrete që nxisin kohezionin e brendshëm social-ekonomik të territorit<sup>4</sup>. Për këtë qëllim, dldp rekomandon përshtatjen (në nivelin e mundur) e Fondit të Agjencisë për Zbatimin e Refomës Territoriale (AZRT), por edhe të Fondit të Zhvillimit të Rajoneve (FZHR), Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FShZh) apo formulës së rishikuar, për të lehtësuar identifikimin dhe aprovimin e projekteve të kësaj natyre. Një **listë e kritereve** që mund të përdoren për këtë qëllim jepen në **Lidhjen 2**.

---

<sup>1</sup> Mësim nga pilotimi I *Zyrave të Integruara me Një Ndalesë*. Për më shumë shikoni *Rekomandime nga përvoja e Zyrave të Integruara me Një Ndalesë* (draft për konsultim), të cilën e gjeni në <http://www.km.dldp.al/wp-multimedia/fap/Rekomandime%20nga%20ushtrimi%20per%20IOSH%20-%20dokument%20per%20konsultim%20-%20dldp.docx> (draft për konsultim).

<sup>2</sup> Mësim i nxjerrë nga pilotimi I programit të zonave funksionale në 9 NJQV partnere të dldp. Për më shumë shikoni *Raportin e Konferencës Kombëtare 11 Maj 2015* (draft për konsultim) dhe *Metodologjinë për Programin e Zonave Funksionale*, të cilat i gjeni në <http://www.km.dldp.al/wp-multimedia/fap/Report%20of%20Functional%20Areas%20Program%20Conference11May2015%20-%20Consultation%20Draft%20-%20dldp.docx>

<sup>3</sup> Mësim i nxjerrë nga përvoja e dldp me planifikimin strategjik, validuar me Ministrinë e Financave dhe STAR/UNDP. Për më shumë shiko Metodologjinë SDPeMTBP në <http://www.km.dldp.al/category/public-finance-management-know-how/manuals/?lang=sq>

<sup>4</sup> Mësim të nxjerra nga procesi i vlerësimit të projekteve të identifikuar nga *Programi i Zonave Funksionale*. Një listë të këtyre projekteve <http://www.km.dldp.al/fap/?lang=en>.

5. Në funksion të riorganizimit të NJQV të rikonstituara dhe Njësive Administrative, dldp prezanton një **skemë alternative të organogramës së ardhshme të NJQV**<sup>5</sup>, validuar me të gjithë aktorët në Konferencën Kombëtare (11 Maj, 2015)<sup>6</sup>. (**Lidhja 3**).
6. Në kuadër të forcimit të kapaciteteve të NJQV të reja, për nevoja ad-hoc të informimit dhe trajnimit të administratave vendore, dldp propozon krijimin e një **platforme online** të administruar nga Shkolla Publike e Administratës Publike në bashkëpunim të ngushtë Ministrin e Shtetit për Çështjet Vendore, ku të sillen sipas politikave të zhvilluara nga ministria të gjitha **kontributet e programeve apo aktorëve të angazhuar në zhvillimin e kurrikulave**, që do u shërbejnë NJQV në periudhën tranzitore. Ky do ishte një hap I parë, për një platformë të konsoliduar sipas identifikimit të nevojave për edukim të vazhduar të NJQV.

---

<sup>5</sup> Rezultat i pilotimit të Zyrave të Integruara me Një Ndalesë dhe Programit të Zonave Funksionale.

<sup>6</sup> Angazhimi i dldp në zhvillimin e modelit të strukturave organizative dhe në ngritjen e platformave për zhvillimin e trainimeve dhe kurrikulave janë komplementare me inisiativën tjetër të projektit Këshillit të Europës të mbështetur nga qeveria zvicerane.

## Lidhja 1

### UDHËZIM

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_

#### **MBI PËRGATITJEN DHE MIRATIMIN E NJË “RREGULLORE PËR MENAXHIMIN E PROCESVEVE TË PUNËS PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE NDAJ PUBLIKUT NGA BASHKIA DHE NJËSITË ADMINISTRATIVE NË PËRBËRJE TË SAJ” NGA NJËSITË E QEVERISJES VENDORE**

Bazuar në xxxxxxxx, si dhe në kuadër të paketës së udhëzimeve për mirëfunksionimin e njësive të qeverisjes vendore me fillimin e zbatimit të ndarjes së re administrative territoriale, XXXXX (autoriteti që lëshon aktin),

### UDHËZON

1. Bashkitë dhe Njësitë Administrative ofrojnë shërbime për publikun në përputhje me ligjin që rregullon organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore, aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi që përcaktojnë shprehimisht kompetenca dhe përgjegjësi të njësive të qeverisjes vendore, si dhe akte të vetë njësive të qeverisjes vendore.
2. Kryetari i Bashkisë përgatit dhe kujdeset për miratimin e një “Rregullore për menaxhimin e proceseve të punës për ofrimin e shërbimeve ndaj publikut, nga Bashkia dhe Njësitë Administrative në përbërje të saj”.
3. Rregullorja përcakton modelin institucional për ofrimin e shërbimeve ndaj publikut, duke ndjekur hapat e mëposhtëm:
  - i. Qytetari aplikon për shërbimin në sportelet e Njesisë Administrative/Bashkisë;
  - ii. Kërkesa përcillet në Zyrat Përpunuese (backoffice) për trajtim;
  - iii. Kërkesa trajtohet në Zyrat Përpunuese (backoffice) në Bashki;
  - iv. Përgatitet përgjigja në Njësinë Administrative.
4. Për mundësimin e zbatimit të modelit institucional, Kryetari i Bashkisë:
  - i. Miraton listën e shërbimeve (me përfshirjen e Këshillit Bashkiak);
  - ii. Miraton procedurat e punës për secilin shërbim;
  - iii. Siguron delegimin e të drejtës së përdorimit të vulës për dokumentat e prodhuara nga shërbimet standarte (nga këshilli bashkiak).
5. Rregullorja duhet të përcaktojë listën e shërbimeve për publikun. Për secilin nga shërbimet, Rregullorja duhet të përcaktojë:
  - i. Bazën Ligjore që rregullon shërbimin;
  - ii. Përfituesin e këtij shërbimi (Individ, Tregtar, organizatë, etj.);
  - iii. Formularin/et që duhet të plotësojë aplikanti në momentin e aplikimit për shërbimin;

- iv. Kriteret që duhet të plotësojë aplikanti për shërbimin e kërkuar (parakushtet);
  - v. Listën e saktë të dokumenteve që duhet të paraqesë aplikanti;
  - vi. Afatin e trajtimit të kërkesës së aplikantit;
  - vii. Zyrën përgjegjëse për trajtimin e këtij shërbimi;
  - viii. Hapat në të cilat kalon procesi i trajtimit të kërkesës. Për çdo njërin nga hapat duhet të përcaktohet:
    - a. Zyra përgjegjëse;
    - b. Afati i trajtimit;
    - c. Fakti nëse ka apo jo ndërveprim me aplikantin;
    - ç. Fakti nëse ka apo jo verifikime në terren (në rast se ka verifikim në terren, të përcaktohet një formular tip që plotësohet me rezultatet e verifikimit në terren, si dhe procesi përkatës).
  - ix. Dokumentin/Dokumentat që prodhohen si rezultat i aplikimit:
    - a. Për çdo dokument të përcaktohet formati;
    - b. Vlefshmëria në kohë e dokumentit (liçensës/certifikatës/autorizimit, etj.).
6. Për dokumentat për të cilat formatet nuk janë të përcaktuara me akte ligjore apo nënligjore në fuqi Bashkia përgatit dhe miraton formatet përkatëse dhe i bën pjesë të Rregullores së shërbimeve.
7. Lista e shërbimeve të ofruara nga Bashkitë dhe Njësitë Administrative miratohet dhe bëhet pjesë e *“Rregullores për menaxhimin e proceseve të punës për ofrimin e shërbimeve ndaj publikut nga Bashkia dhe Njësitë Administrative në përbërje të saj”*. Shërbimet grupohen sipas modaliteteve të ofrimit të shërbimit<sup>7</sup>, në:
  - i. Shërbime që trajtohen në Bashki (qendër) dhe formalizohen në Njësinë Administrative;
  - ii. Shërbime që trajtohen në Bashki (qendër) dhe në Njësinë Administrative;
  - iii. Shërbime që trajtohen në Bashki (qendër).
  - iv. Shërbime që trajtohen në Njësinë Administrative;
8. Në Bashkitë ku ndërlidhja e qendrës me Njësitë Administrative mund të bëhet përmes përdorimit të teknologjisë së informacionit (zyrave të integruara me një ndalesë), struktura organizative e Njësisë Administrative, siguron shkëmbimin e informacionit me Bashkinë dhe anasjelltas. Zyrat me një ndalesë mund të ofrojnë shërbime edhe për subjekte të treta, të cilat ofrojnë shërbime ndaj publikut.

---

<sup>7</sup> Për skenarët e grupimit të shërbimeve, shiko Lidhjen e këtij Udhëzimi.

## Lidhja e Udhëzimit

### Modele të grupimit të shërbimeve

#### Skenari 1 - Shërbimi trajtohet në qendër formalizohet në njësinë administrative

1. Liçensa transporti.
2. Kërkesë për informacion.
3. Ankesë.
4. Vërtetim shlyerje detyrimesh vendore.
5. Vërtetim pagese të taksës së infrastrukturës për legalizim.
6. Kërkesë për bursë studimi brenda vendit.
7. Kërkesë për përfitim ndihme financiare në rast djegie banese.
8. *Vërtetimi i të ardhurave ekonomike (Nëse janë të dhëna të dixhitalizuara, në të kundërt mbetet shërbimi në njësinë administrative).*
9. Kërkesë për pranim të personave të moshuar në institucionet rezidenciale.
10. Kërkesë për pranim të personave me aftësi ndryshe në institucionet rezidenciale.
11. Kërkesë për ndihmë ekonomike për shërbim kujdestarie për të mitur.
12. Kërkesë për Strehim.
13. Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit.
14. Liçensë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit.
15. Çertifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt ndërqytetëse brenda qarkut.
16. Liçensë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt ndërqytetëse brenda qarkut.
17. Çertifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt rrethqytetëse.
18. Liçensë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt rrethqytetëse.
19. Çertifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt qytetëse.
20. Liçensë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt qytetëse.
21. Leje kalimi kundra sinjalit rrugor, ndalim qarkullimi.
22. Çertifikatë për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet.
23. Autorizim i lëvizjes jashtë linjës pa ndalesë.
24. Të tjera

#### Skenari 2 - Shërbimi trajtohet pjesërisht në qendër dhe në Njësinë Administrative

1. Leje për plazh privat.
2. Leje për vendosje reklame
3. Autorizim për tregtim me pakicë të karburanteve (*vetëm në qytetet në përbërje të Bashkisë*).
4. Për reduktim të taksës familjare.
5. Kërkesë për vend parkim të rezervuar.
6. Kërkesë për fotokopje dokumenti arshivor, njësuar me origjinalin (nëse ka arkiva të dixhitalizuara, shërbimi ofrohet vetëm në qendër).
7. Leje për shfrytëzim të hapësirës publike.
8. Vërtetim për trajtim me ndihmë ekonomike.
9. Regjistrim për përfitim të pagesës për personat me aftësi ndryshe.
10. Regjistrim për përfitimin e pagesës për verbërinë.
11. Kërkesë për përfitimin e ndihmës ekonomike.
12. Regjistrim për përfitimin e pagesës së shtesës së invaliditetit.

13. Regjistrim për përfitim pagese për paraplegjikë dhe tetraplegjikë.
14. Vërtetim trajtimi me pagesën e aftësisë ndryshe.
15. Të tjera

### **Skenari 3 - Shërbimi trajtohet në Njësinë Administrative**

1. Konfirmim për azhornim të pronës.
2. Vërtetim për ushtrim aktiviteti bujqësor dhe blegtoral.
3. Kërkesë për pajisje me aktin e marrjes së tokës në pronësi.
4. Vërtetim fakti për qënien anëtar i ish kooperativës bujqësore deri me 01 Gusht 1991.
5. Vërtetim i pasjes së tokës në pronësi/përdorim.
6. Vërtetim bashkëjetese.
7. Saktësim adrese banimi.
8. Kërkesë për shërbim Sanitar-Veterinar në komunitet.
9. Për njohje të tokës bujqësore.
10. Vërtetim Identiteti.
11. Autorizim për transportimin e kufomave.
12. Të tjera

### **Skenari 4 – Shërbimi trajtohet vetëm në Bashki**

1. Leje veterinare për pikë grumbullimi lëkurash.
2. Leje veterinare për njësi/punishte bulmeti.
3. Leje veterinare për fabrikë sallami.
4. Për qeranë e trojeve nën objekt.
5. Leje për prerje lëndë drusore.
6. Dhënie me qira e asetëve të njësisë vendore, pajisje teknologjike.
7. Konfirmim kufizim prone private me pronë shteti.
8. Për privatizimin e banesave.
9. Leje për tregtim mishi.
10. Leje zhvillimore të veçanta.
11. Leja e përdorimit për urbanistikën.
12. Leje zhvillimore infrastrukture.
13. Leje zhvillimore ndërtimore.
14. Leje për vendosje reklamash
15. Kërkesë për privatizim banese për objektet e ndërtuara para 1991.
16. Kërkesë për leje zhvarrimi.
17. Çertifikatë për transportin e udhëtarëve me taksì.
18. Liçensim për transportin e udhëtarëve me taksì.
19. Të tjera

## Lidhja 2

### Lista e kriterëve për vlerësimin e projektideve<sup>8</sup> për tre kategori

#### I. Projekte për Shërbimet Publike

<b>A. Kriteret të përgjithshme (70%)</b>	<b>Pikët</b>
1. Përqindja e popullsisë së ZF që përfiton nga projekti	/30
2. Përqindja e territorit të ZF që mbulohet nga projekt-idea e propozuar	/10
3. Kontributi i projektit në kohezionin e ZF	/10
4. Projekti është urgjent dhe vijimësi e nismave ekzistuese	/10
5. Pjekuria e projektit.	/10
<b>Pikëzimi gjithsej për kriteret e përgjithshme</b>	<b>/70</b>

<b>B. Kriteret specifike (30 %)</b>	<b>Pikët</b>
1. Niveli i përmirësimit të shërbimit	/15
2. Pajtueshmëria me rekomandimet e analizave të shërbimeve publike	/15
<b>Pikëzimi gjithsej për kriteret specifike</b>	<b>/30</b>

<b>Pikëzimi përfundimtar</b>	<b>Pikët</b>
Kriteret të përgjithshme	/70
Kriteret specifike	/30
<b>Gjithsej</b>	<b>/100</b>

#### II. Projekte për Zhvillimin Ekonomik

<b>A. Kriteret të përgjithshme (70%)</b>	<b>Pikët</b>
1. Përqindja e popullsisë së ZF që përfiton nga projekti	/30
2. Përqindja e territorit të ZF që mbulohet nga projekt-idea e propozuar	/10
3. Kontributi i projektit në kohezionin e ZF	/10
4. Projekti është urgjent dhe vijimësi e nismave ekzistuese	/10
5. Pjekuria e projektit	/10
<b>Pikëzimi total për kriteret e përgjithshme</b>	<b>/70</b>

<b>B. Kriteret specifike (30 %)</b>	<b>Score</b>
1. Një kthim i lartë i investimit.	/15
2. Pajtueshmëria me rekomandimet e analizave ekonomike	/15
<b>Pikëzimi gjithsej për kriteret specifike</b>	<b>/30</b>

<b>Pikëzimi përfundimtar</b>	<b>Pikët</b>
Kriteret të përgjithshme	/70
Kriteret specifike	/30
<b>Gjithsej</b>	<b>/100</b>

<sup>8</sup> Pikët janë vendosur për të treguar peshën e secilit kriter në procesin e vlerësimit

### III. Projekte të fillimit të shpejtë (quick start)

<b>A. Kritere të përgjithshme (70%)</b>	<b>Pikët</b>
1. Përqindja e popullsisë së ZF që përfiton nga projekti	/30
2. Përqindja e territorit të ZF që mbulohet nga projekt-idea e propozuar	/10
3. Kontributi i projektit në kohezionin e ZF	/10
4. Projekti është urgjent dhe vijimësi e nismave ekzistuese	/10
5. Pjekuria e projektit	/10
<b>Pikëzimi gjithsej për kriteret e përgjithshme</b>	<b>/70</b>

<b>B. Kritere specifike (30 %)</b>	<b>Score</b>
1. Mundësia e fillimit të menjëhershëm të projektit	/15
2. Pajtueshmëria me rekomandimet e analizave të qeverisjes dhe rekomandimeve për strukturat organizative	/15
<b>Pikëzimi gjithsej për kriteret specifike</b>	<b>/30</b>

<b>Pikëzimi përfundimtar</b>	<b>Pikët</b>
Kritere të përgjithshme	/70
Kritere specifike	/30
<b>Gjithsej</b>	<b>/100</b>



### Lidhja 3

#### Modeli organizativ i Bashkive të reja i propozuar nga dldp

